

VENDIM
Nr. 761, datë 7.11.2012

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, QË PREKEN NGA SISTEMIMI I RRUGËVE DHE LULISHTEVE NË TË
DYJA ANËT E RRUGËS KRYESORE TË KOMBINATIT, NË BASHKINË E TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga sistemimi i rrugëve dhe lulishteve në të dyja anët e rrugës kryesore të Kombinatit, në Bashkinë e Tiranës.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë së Tiranës.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, të kompensohen sipas masës përkatëse, dhënë në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për sipërfaqen 3 788.6 (tri mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e tetë pikë gjashtë) m², truall, në vlerën e përgjithshme 78 488 426.2 (shtatëdhjetë e tetë milionë e katërqind e tetëdhjetë e tetë mijë e katërqind e njëzet e gjashtë pikë dy) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 78 488 426.2 (shtatëdhjetë e tetë milionë e katërqind e tetëdhjetë e tetë mijë e katërqind e njëzet e gjashtë pikë dy) lekësh, të përballohet nga buxheti i Bashkisë së Tiranës, sipas planifikimit përkatës të kësaj bashkie.

5. Afati i përfundimit të procedurës së shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

6. Vlera e shpenzimeve procedurale do të përballohet nga Bashkia e Tiranës.

7. Afati i përfundimit të punimeve për këtë objekt të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia e Tiranës, për realizimin e këtij projekti.

8. Regjistrimi i ri i pasurisë prej 3 788.6 (tri mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e tetë pikë gjashtë) m², truall, shpronësuar në favor të Bashkisë së Tiranës, të bëhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

9. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Bashkia e Tiranës për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha